



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.169 dt.06.11.1998

**MIRATIM I RAPORTIT ANALIZES MBI PUNEN E BERE DHE QE DO TE
BEHET PER KANALIZIMET DHE SHTRIMIN E RRUGEVE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur në dt.06.11.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Shërbimeve “Raport analize mbi punën e bërë dhe që po bëhet për kanalizimet dhe shtrimin e rrugëve”, mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”

VENDOSI

1. Të bëhet studimi për hartimin e plan organizimit për pastrimin e Lanës.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike dhe Shërbimeve dhe Sektori Infrastrukturës në Drejtorinë e Urbanistikës.
Materiali të paraqitet brenda muajit Dhjetor 1998 për miratimin dhe zbatimin të bëhet në vitin 1999.
2. Të bëhet studimi për përcaktimin e fondeve të nevojshme për projektimin e KUZ dhe sistemimin e asfaltimin e rrugëve për zonat më të dëmtuara me qëllim ndërhyrje për një periudhë dy vjeçare.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve, Drejtoria e Urbanistikës.

Afati përfundimtar 31 Dhjetor 1998.

3. Për përballimin e emergjencave që i paraqiten Bashkisë së Tiranës për infrastrukturën të mirtohet një fond prej 8 milion lekë nga të ardhurat e Bashkisë dhe të përdoren me miratim të Kryetarit të Bashkisë për vënie në dispozicionin të saj, makineritë dhe fuqinë punëtore të nevojshme për përballimin e gjendjes.
Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financave.
4. Të bëhet studimi për vlerën e taksës që duhet për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e kanalizimeve të ujrave të zeza.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike e Shërbimeve dhe Zyra e Taksave.
Afati i studimit Janar 1999.
5. Të paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak një material për fondet e nevojshme që duhen për kompletim me makineri dhe pajisje Ndërmarrje Rrugë Kanalizime.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve dhe Drejtoria Financës.
Afati brenda muajit Nëntor 1998.
6. Të paraqiten për miratim në Këshillin Bashkiak materiali studimor për kalimin me vetfinancim brenda kuadrit të ndërmarrjes, sektori i prodhimit të asfalto betonit dhe pllaka bituminoze.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve dhe Ndërmarrja e Rrugë Kanalizimeve.
Afati deri në 31 Dhjetor 1998.
7. T'i bëhet propozim Qeverisë për rritjen e pagesës së specialistëve të veçantë për kanalizimet e ujrave të zeza, si sektor i vështirë dhe me rreziqe infeksioni.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike e Shërbimeve, Drejtoria e Financës.
Afati deri në 31 Dhjetor 1998.

8. Të bëhet projekti dhe të paraqiten nevojat për fonde për riparimin e Bulevardit Dëshmorët e Kombit dhe Sheshit Skënderbej.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës.
Afati 31 Dhjetor 1998.
9. Të hartohet projekti plotësues i Unazës së Vogël (pranë Hotel Peza).
Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës.
Afati deri në 30 Janar 1999.
10. Të hartohet projekti për ndërtimin e kaperdedhevesave për rrugët në të dy anët e Lanës.
Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve.
Afati deri në 30 Dhjetor 1998.
11. Të hartohet projekti për ndërtimin e kaperdedhevesave për në rrugën Mine Peza deri në datën 31 Dhjetor 1998 dhe Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike e Shërbimeve ta paraqesi për çelje fondi në Këshillin Bashkiak.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI